[Shqiptarja.com]

E hënë 11 Maj 2026 - Përditësimi i fundit 16:08

Kërko

LIVE Shqiptarja.tv

HOME EDICIONET LOKALE KRONIKË POLITIKË SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË EDITORIAL OPINION
TË FUNDIT SOCIALE DREJT PUNËS SPECIALE LAJMET E MIRA LIFESTYLE VIP & SPEKTAKEL RECETA HOROSKOPI DOSJE FOTOGALERI VIDEOGALERI PIKË E ZEZË SONDAZHE

POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1 Hetimet për dosjen AKSHI, kërcënimi dhe tritoli, Endri Mekaj fikënet në SPAK (VIDEO)

2 Ndryshimet në rregulloren e Kuvendit, Niko Peleshi dorëzon propozimet: Transkripti i plotë i mbledhjeve të komisionenve, kartelë 'SE' për propozitagjet europiane

3 Afera 'Partizani', dëshmonjësi sh-presidentët e klubit! G.MXO fikënet edhe 5 deshmitarë (VIDEO)

4 Paralizohet Hormuzi, mbi 1 mujt anije të bllokuara në Gjirin Persik, mallra me vlerë 23.7 miliardë dollarë në prita, tranzitet bien me 89%

5 Zvarritet...

Kronikë

# Marshimi i PD dështoi/ 6 militantë nën hetim për sulmet me molotovë ndaj policëve, Klevis Balliu si organizator

*PD-së i dështoi skenari i protestës për të marshuar rrugëve të kryeqytetit. Ndërsa militantët po përpiqeshin të shkonin drejt Ministrisë së Brendshme, Policia i bllokoi me kordonë. 3 efektivë u lënduan nga sulmet me molotovë, ndërsa nën hetim është marrë edhe Klevis Balliu i cili në emër të PD-së ka njoftuar policinë për zhvillimin e protestës.*

- VIDEOLAJM/ Skandali i militantit të Berishës, hedh bombën molotov në mes të turmës së protestuesve!
- 'Squllet' protesta e PD/ Hita s'lejon marshimin drejt ministrive, policia i 'rrethon' në Bulevard

Sh.com Redaksia
9 Maj, 10:29 | Përditësimi: 9 Maj, 16:03

Share Post

TIRANË- *Gjashtë militantë të cilët hodhën bomba molotovë pa kontroll mes mbështetësve të opozitës në protestë dhe pranë efektivëve, u vunë në hetim nga Policia e Tiranës, pas tubimit të PD-së të premten. Bashkë me ta, edhe deputeti Klevis Balliu, i cili në emër të PD-së njoftoi policinë për zhvillimin e protestës te Bulevardi 'Dëshmorët e Kombit', para kryeministrisë. Sapo opozita hentoi një marshim drejt Ministrisë së Brendshme, policia i bllokoi me kordonë duke i zmbrapsur në sel.*

***

Me ardhjen e Skënder Hitës në krye të Policisë së Shtetit, dhe provës që dha nën menaxhimin për herë të parë prej tij të një proteste të opozitës, në atë të 17 prillit, Sali Berisha u tërhoq nga disa skenarë.

I konsideruari grupi i zjarrit, që e shoqëronte pas, fshehur pas pankartave e me maska në fytyrë gjatë parakalimit drejt kryeministrisë, mungoi.

Këtë radhë, kreu i partisë Demokratike, u shfaq pranë godinës së qeverisë, me shoqëruesit e tij, me pak militantë, asnjëri i kamuflluar. Por grupi i zjarrit, nuk ishte zhdukur. Në dukje, vetëm ishte larguar nga Berisha. Grupet e personave të maskuar dhe me molotovë e mjete piroteknike në duar, u shfaqën gjatë marshimit që synoi të mbërrinte Ministrinë e Brendshme.

Këto momente u fiksuan nga Report Tv gjatë protestës. Disa militantë me lëndë shpërthyese në duar, shpërthimi i të cilave përfundonte deri në këmbët e policisë, vendosur në kordon përbri Galerisë së Arteve.

Të tjerë, jo kaq të ekspozuar. Ata fshihen pas makinës teknike të televizionit të familjes Berisha, Syri Tv, që në këtë rast *ka shërbyer si mburoja* për të mos u pikasur nga policia. Hedhja e molotovëve dhe fishekzjarrëve është totalisht pa shënjestër. Lëshuar me personave që ndodhen në protestë, mes njerëzve të tyre, mbështetës të partisë Demokratike, e duke rrezikuar gjithashtu edhe forcat e policisë.

Policia tha zyrtarisht se gjatë tubimit disa persona hodhën lëndë djegëse (molotov), lëndë piroteknike, kundërshtuan dhe goditën punonjësit e Policisë me sende të forta dhe për pasojë u lënduan 3 punonjës policie. Por këtë radhë nga policia, nuk pati të arrestuar. 6 militantë të cilët hodhën molotovë, u vunë në hetim, për 3 vepra penale, "Kundërshtimi i punonjësit të rendit publik", "Goditja për shkak të detyrës" dhe "Prishja e rendit dhe qetësisë publike". Bashkë me ta, në hetim edhe Klevis Balliu, i cili në emër të PD-së ka njoftuar policinë për zhvillimin e protestës, e cila u tentua të zhvendoset jashtë perimetrit të lejes.

> *"Policia e Tiranës, menjëherë pas përfundimit të tubimit të organizuar nga subjekti politik Partia Demokratike mbrëmjen e datës 08.05.2026, në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit", ku gjatë tubimit disa persona hodhën lëndë djegëse (molotov), lëndë piroteknike, kundërshtuan dhe goditën punonjësit e Policisë me sende të forta dhe për pasojë u lënduan 3 punonjës policie, procedoi penalisht 7 shtetas. Nga këta: 6 për veprat penale "Kundërshtimi i punonjësit të rendit publik", "Goditja për shkak të detyrës" dhe "Prishja e rendit dhe qetësisë publike", dhe një shtetas (deputet) për veprën penale "Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime dhe manifestime të paligjshme". Gjatë veprimeve, policia sekuestroi 1 molotov, lëndë piroteknike dhe sende të forta", njoftojnë policia.*

Protesta marshim e opozitës të premten dështoi të mbërrijë destinacionin e saj, Ministrinë e Brendshme, pasi policia i bllokoi duke i zmbrapsur në seli me një autobot ujëndhësë.

E tkurrur në numra sikurse pamjet e treguan, protesta u mbyll pas 90 minutash me një paralajmërim të Berishës se regjimi do marrë përgjigjie, dhe pa datë për takimin e radhës.

Strategjia e shpërndarjes së turmës pa dalë jashtë zonës për të cilën është njoftuar protesta dhe arrestimi i militantëve me çanta me molotovë në duar, i la në burg 5 prej tyre nga Gjykata e Tiranës, për episodet e dhunshme ne tubimin e 17 prillit

---

**Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë**

Sl.E./E.H/Shqiptarja.com

TAG: klevis balliu | Tirane | policia e tiranes | PD | protesta e pd 8 maj

Komento

## Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**PS propozon masa më të ashpra për shoferët e dehur e ata të rinj, si iu duket?**

9 Maj, 13:00

E drejtë | E gabuar | Nuk e di

## Lajme të tjera

'I la demokratët rrugëve për 13 vjet', Salianji sulmon Berishën në përvjetorin e disfatës së 11 majit 2025: Po e çon PD-në drejt shuarjes

11 Maj, 13:27



Shqipëria modernizon auditimin e brendshëm, Malaj: Synojmë standarde europiane të kontrollit financiar

11 Maj, 14:48

Sulmet ndaj Gonzatos, Berisha nuk tërhiqet: Akuzat i kam të bazuara në të paktën 2 burime! Duhet të punojmë me mënyrën e organizimit të protestave (VIDEO)

11 Maj, 12:55

U dhunua barbarisht në rrugë, kush është ish-kreu i PD në Lezhë, Sokol Toma! I dënuar nga GJKKO për tjetërsimin e pronave në bregdet, aktualisht në hetim për vdekjen e punëtorit të ndërtimit

11 Maj, 12:06

SPAK do pushimin e hetimit për Irena Gjokën/ GJKKO rrëzon kërkesën e PD: Çështjen e shqyrtojmë ne, jo gjykatë tjetër! S'përjashtohet as gjyqtarja Osmani

Keti Banushi

11 Maj, 10:30

Dhunimi barbar i ish-kreut të PD në Lezhë, autorët ende në arrati! Policia: Kemi sekuestruar pamje filmike

11 Maj, 09:28

Protesta e 17 prillit/ U kapën me molotovë në duar, Apeli liron nga qelia 5 militantët e Berishës! U caktohet masa 'detyrim paraqitje'

11 Maj, 09:19

Protesta e PD/ Hidhnin molotovë tinëz pas makinës së Syrit, pyetja e Ballës: Kush i solli tre italianët e procedurat penalisht?

10 Maj, 22:44



Salianji mohon akuzat për takime me Ballën dhe paralajmëron se po përgatit një dosje për Berishën: Ka lidhje me krimin e organizuar

10 Maj, 20:20

Lajmi i fundit

**Operacion antidrogë në Maliq/ Zbulohet 'shtëpi bari' poshtë kotecit të pulave, një person i arrestuar dhe një i shpallur në kërkim**

11 Maj, 16:06